



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 701/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Muça” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-73534-06-05-2018, me objekt : “Blerje pajisje për kopshte dhe çerdhet”, me fond limit 9'506'000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 06.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Ankimues:**

“Muça” sh.p.k.  
Adresa: Autostada Durrës –Tiranë, KM 13 Picar Vorë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Durrës  
Adresa: Sheshi“Liria” Durrës

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për

*miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.06.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73534-06-05-2018, me objekt : “*Blerje pajisje për kopshte dhe çerdhet*”, me fond limit 9'506'000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 06.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 06.07.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 01.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

Buna	pa ofertë ekonomike	I skualifikuar
Bolt	8,127,300 lekë	I skualifikuar
Muca	8,876,000 lekë	I skualifikuar
Shaga	8,958,950 lekë	I kualifikuar
Hasanago	9,317,200 lekë	I kualifikuar
Prend Stojani	9,506,000 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 01.08.2018 operatori ekonomik “Muça” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*- Ofertuesi MUCA me vlerë të ofertës 8'876'000 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentat e tenderit e konkretisht;*

*Kërkohet certifikatë ISO 9001/deklaratë komformiteti e prodhuesit për cilesinë e produktit të kerkuar më poshtë • cilesinë e paisjeve prej druri.*

*Ofertuesi MUCA ka paraqitur certifikatë ISO 9001 për tregëtim me shumicë dhe pakicë të mobilerise, dhe jo për prodhimin e tyre. KVO vendos që ofertuesi të mos kualifikohet.*

II.5. Në datën 07.08.2018, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

*AK-ja Bashkia Durrës më datë 06.07.2018 ka zhvilluar tenderin me objektin e mësipërm. Shoqëria jonë me përvojë në këtë fushë , ka marrë pjesë në këtë garë, duke dorëzuar ofertën e saj shoqëruar me të gjitha dokumentat e kërkuara në DT, sipas LPP-së dhe të VKM-së për RrPPP-në.*

*Më datën 01.08.2018 nëpërmjet SPE –së na vijnë 2 mesazhet e KVO-së , së AK-së Durrës. Nëpërmjet mesazhit të parë njoftohemi për klasifikimin e ofertuesve si më poshtë:*

- Buna	pa ofertë ekonomike	I skualifikuar
- Bolt	8,127,300 lekë	I skualifikuar
- Muca	8,876,000 lekë	I skualifikuar
- Shaga	8,958,950 lekë	I kualifikuar
- Hasanago	9,317,200 lekë	I kualifikuar
- Prend Stojani	9,506,000 lekë	I skualifikuar

*Ku shohim se oferta e shoqërisë tonë është refuzuar dhe.... nëpërmjet mesazhittë dytë njoftohemi për arsyen e refuzimit, që sipas KVO-së përkatëse është:*

*- Ofertuesi MUCA me vlerë të ofertës 8'876'000 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentat e tenderit e konkretisht;*

*Kërkohet certifikatë ISO 9001/deklaratë komformiteti e prodhuesit për cilësinë e produktit të kërkuar më poshtë • cilësinë e paisjeve prej druri.*

*Ofertuesi MUCA ka paraqitur certifikatë ISO 9001 për tregëtim me shumicë dhe pakicë të mobilerise, dhe jo për prodhimin e tyre. KVO vendos që ofertuesi të mos kualifikohet.*

*Ndaj këtij vendimi të KVO-së po paraqesim formularin e Ankesës pranë AK-së brenda afateve ligjore mbështetur në nenin 63 të LPP-së duke respektuar shkallët e ankimit.*

*Pësa i përket arsyes së vetme të skualifikimit sqarojmë:*

*Në DT kërkesat për kualifikim kapaciteti teknik pika 21.3. thuhet:*

*Kërkohet certifikate ISO 9001/deklarate komformiteti e prodhuesit per cilesine e produktit te kerkuar me poshte*

*cilesine e paisjeve prej druri.*

*Per produktet e mesiperme operatori ekonomik duhet te vertetoje me marreveshje bashkepunimi te zyrtarizuar e cila te tregoje qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, email, ëebsite, etj, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi, si dhe duhet te paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) te jene te perkthyer ne ato pjese qe pasqyrojne specifikimet teknike qe kerkohen ne dokumentat e tenderit, sipas te dhenave te treguara ne preventive dhe specifikimet teknike te dhena nga projektuesi dhe qe ofrohen nga ana juaj.*

*Sic kërkohet nga kërkesa 2.3. gërma h) e DT e shënuar më lart nga mënyra sesi është shkruar (ISO 9001/deklaratë komformiteti), me këtë kërkesë AK-ja kërkon që operatorët ekonomikë të paraqesin tender:*

*Ose certifikatë ISO 9001 e prodhuesit ose Deklaratë komformiteti e prodhuesit për cilësinë e produktit të kërkuar më poshtë  cilesine e paisjeve prej druri (shenja /). Gjithashtu në vazhdim të kërkesës 2.3. gërma h) për pajisjet e drurit AK-ja kërkon që në rast se oe-ja nuk janë prodhues, ata të paraqesin autorizim prodhuesi....*

*Gjithashtu po në vazhdim të kërkesës 2.3. gërma h) për pajisjet e drurit AK-ja kërkon q ëoe të paraqesin katalogfje të prodhuesit (në rastin kur nuk janë prodhues), ose vetiake kur ato janë prodhues, në të cilët të shprehen ST të kërkuara në DT.*

*Në plotësim të këtyre kërkesave të pikës 2.3. gërma h) “Muca” sh.p.k. ka paraqitur:*

*Ekstraktin e QKB-së në të cilin është shpreur qartë në objektivin e veprimtarisë së shoqërisë përvec të tjerash përfshihet edhe “prodhimi dhe tregtimi i artikujve të ndryshëm të drurit”*

*Katalog vetjak me logon e shoqërisë tregtuese dhe prodhuese “Muca” shpk në të cilin shprehen në ST të DT.*

*Certifikatë ISO 9001:2015, e shoqërisë “Muca” shpk e cila, në rastin konkret është dhe prodhuese edhe tregtuese e pajisjeve të drurit. Etj.*

*I nderuar kryetar i AK-së*

*Sic e ka paranuar me të drejtë KVO-ja (sepse i ka quajtur të plotësuar kriteret e autorizimit të prodhuesit dhe katalogun me logon vetjake), shoqëria “Muca” shpk është prodhuese e pajisjeve të drurit. Duke qënë kështu në zbatim të pjesës së parë të kërkesës 2.3.h. shoqëria jonë ka*

*paraqitur certifikatën ISO 9001 të prodhuesit që është vet “Muca” shpk, por KVO-ja ka gabuar në interpretimin e kërkesës së DT ose nuk e ka kuptuar atë.*

*KVO-ja përpara se të bënte vlerësimin e ofertave duhet të ishte konsultuar dhe sqaruar me hartuesit e kërkesave për kualifikim të DT dhe në zbatim të ligjit të kërkonte dhe sqarime nga OE për paqartësi të ndryshme. KVO -ja në vlerësimin e saj me skualifikimin e ofertës së shoqërisë tonë ka përdorur kërkesë/kritere e cila nuk është kërkuar në asnjë vend të DT duke shkelur LPP-në konkretisht nenin 55.2 referojmë nenin [....]*

*I kujtojmë anëtarët e KSHA-së se:*

*Së pari në asnjë vend të kërkesave për kualifikim të DT nuk është përcaktuar në mënyrë taksative që objekti i certifikatës ISO e shoqërisë prodhuese duhet të përfshijë prodhimin e pajisjeve të drurit. Ju kujtojmë edhe njëherë që ta lexoni kërkesën në DT*

*Së dyti certifikata ISO9001 tregon menaxhimin e cilësisë së shoqërisë (ska të bëjë me produktet konkrete që prodhon ose shet).*

*Së treti në objektin e certifikatë ISO 9001: 2015, të zotëruar dhe të paraqitur nga “Muca” shpk është i përfshirë totalisht dhe saktësisht objekti i këtij prokurimi për të cilin po ankohemi.*

*Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK-së për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.*

*Për AK-në është e rëndësishme që me dokumentacionin e paraqitur oe pjesmarrës të krijojnë bindje dhe garanci tek AK-ja për realizimin e kontratës. Me dokumentacionin e paraqitur shoqëria jonë plotëson të gjitha kriteret e DT duke krijuar bindjen tek AK-ja për realizimin me sukses të kontratës sipas ST të DT dhe kërkesave dhe afateve të AK-së.*

*Sa më sipër kërkojmë nga titullari i AK-së nëpërmjet KSHA -së interpretim të saktë të kërkesave për kualifikim të dt dhe zbatimin e LPP-së dhe VKM –së për RrPP, duke rrëzuar pretendimin e KVO-së në lidhje me ofertën tonë sin ë shkelje të ligjit. Përfundimisht kërkojmë shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës tonë duke e kualifikuar atë.*

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 6099/2 Prot. datë 09.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik “Muca” sh.p.k. duke mos e pranuar ankesën.

II.7. Në datën 15.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.14668/1datë 24.08.2018 protokolluar me tonën me nr. 1397/2 datë 27.08.2018 me objekt “Dërgohet informacioni për vendimin nr. 1348/1, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit së bashku me mostrat e operatorit ekonomik ankimues.

### III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Muça” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “- *Ofertuesi MUCA me vlerë të ofertës 8’876’000 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të kërkuara në dokumentat e tenderit e konkretisht;*

*Kërkohet certifikatë ISO 9001/deklaratë komformiteti e prodhuesit për cilesinë e produktit të kërkuar më poshtë • cilesinë e paisjeve prej druri.*

*Ofertuesi MUCA ka paraqitur certifikatë ISO 9001 për tregëtim me shumicë dhe pakicë të mobilerise, dhe jo për prodhimin e tyre. KVO vendos që ofertuesi të mos kualifikohet.”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3. gërma h) “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Kërkohet certifikatë ISO 9001/deklaratë komformiteti e prodhuesit për cilesinë e produktit të kërkuar më poshtë*

*cilesinë e paisjeve prej druri.*

*Për produktet e mësipërme operatori ekonomik duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: licensë, telefon, email, ëebsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, sipas të dhënave të treguara në preventivë dhe specifikimet teknike të dhëna nga projektuesi dhe që ofrohen nga ana juaj.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Muça” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*EN ISO 9001: 2015; Fusha e certifikimit: Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të mobilerisë, të pajisjeve të zyrave pajisje të ndryshme të spitaleve dhe institucioneve të tjera*



*publike, vegla buqësore vegla pune dore dhe material elektrike, artikuj të ndryshëm të drurit dhe metalike dhe nënprodukteve të tyre. me datë vlefshmërie deri më 14.06.2020 .*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”*

III.1.5. Në nenin 30 të VKM nr. 914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

*2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”*

III.1.6. Nisur nga sa më sipër konstatuar, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Muça” sh.p.k është në kushtet e mospërmbushjes së kriterit të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor shprehimisht ka kërkuar çertifikatë ISO 9001/deklaratë komformiteti e prodhuesit për cilesinë e produktit, ndërkohë dokumentacioni provues i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Muça” sh.p.k në funksion të përmbushjes së kriterit sa më sipër, dëshmon se certifikata EN ISO 9001: 2015; Fusha e çertifikimit: Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të mobilerisë. Në këtë mënyrë certifikata ISO 9001 e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për provueshmërinë e përmbushjes së kriterit të kualifikimit nuk është i plotë, pasi operatori ekonomik ankimues në bazë të dokumentacionit të paraqitur ka arritur të provojë se disponon dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor vetëm import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të mobilerisë, por jo për prodhimin e tyre. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në

përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato. Komisioni gjykon se çertifikata ISO 9001: e paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

III.1.8. Akoma më tej, sqarojmë se në rast se ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

III.1.9. Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues, do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë*



*sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

III.1.10. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Çertifikata ISO e paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor parashikuara në dokumentat standarte të tenderit. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Muça” sh.p.k nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga “Muça” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-73534-06-05-2018, me objekt : “Blerje pajisje për kopshte dhe çerdhet”, me fond limit 9’506’000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 06.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1397 Protokoli; Datë 15.08.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**